



Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse / Privremena Institucija Samouprave / Provisional Institutions of Self Government

Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Shërbimeve Publike / Ministarstvo javnih službi / Ministry of Public Services



TË MOSHUARIT NË KOSOVË 100 E MË SHUMË VJEÇ



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo



1 Tetori Dita Ndërkombëtare e të moshuarve



Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)
Data e botimit: Dhjetor 2007
© : Enti i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së
në internet: www.ks-gov.net/esk

Parathënie

Më rastin e këtij publikimi falënderojmë gjithë stafin e ESK-së në Prishtinë, dhe bashkëpunëtorët e Zyrave Rajonale të Statistikës për kontributin e dhënë në këtë hulumtim.

Falënderim të veçantë për bashkëpunimin e dhënë për anëtarët e familjeve që ndihmuan në dhënien e informatave të nevojshme.

Po ashtu një falënderim të veçantë për personat që lajmëruan dhe informuan për të afërmit e tyre dhe personat tjerë të moshuar përmes postës elektronike apo telefonit .

Kontribut të çmuar ka dhënë Radio Televizioni i Kosovës i cili ishte sponsor medial i këtij projekti, dhe ndihmoi në sensibilizimin e popullsisë me anë të spotit reklamues për afër 30 ditë.

Në bazë të këtij sensibilizimi ka pasur interesim të shprehur të popullatës nga Kosova dhe nga shtetet e jashtme atje ku jetojnë dhe punojnë kosovarët.

Kontribut të veçantë në këtë hulumtim dhënë:

Zymer Maxharri, zv.Kryeshef në ESK

Kadri Sojeva, Drejtor i Departamentit të Statistikave të Popullsisë

Rahman Tara, Shef i Hartografisë në ESK

Bashkëpunëtorë tjerë:

Idriz Shala
Sanije Uka
Ajshe Avdiu
Shukran Muharremi

Dizajnoi: Ahmet Cakolli

Sponsor medial: RTK

Dhjetor, 2007

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së
Avni Kastrati

Përmbajtja

Faqe

Hyrje	5
Sistemi statistikor i Kosovës	6
Qëllimi i hulumtimit	7
Metodologjia	8
Koha e realizimit të hulumtimit	8
Disa të dhëna mbi jetëgjatësinë në nivelin botëror	9
Më të moshuarit në botë.....	11
Të moshuarit mbi 100 e më shumë vjeç në Kosovë	12
Disa karakteristika në Kosovë për të moshuarit mbi 100 vjeç.....	12
Shtrirja territoriale e të moshuarve sipas komunave	13
Pjesëmarrja e të moshuarve sipas vendqëndrimit të përhershëm	14
Pjesëmarrja e të moshuarve në 100 mijë banorë	15
Të moshuarit sipas vendqëndrimit dhe komunës së lindjes.....	17
Lista e personave më të moshuar në Kosovë	18
Të moshuarit sipas vitit të lindjes	19
Të moshuarit sipas lartësisë mbidetare të vendbanimit	20
Të moshuarit sipas gjinisë	20
Të moshuarit dhe pasardhësit	21
Të moshuarit sipas profesionit	21
Të moshuarit dhe konsumimi i duhanit.....	22
Të moshuarit dhe konsumimi i ushqimit	22
Të moshuarit dhe përdorimi i yndyrave	22
Të moshuarit dhe përdorimi i alkoolit	23
Të moshuarit dhe gjendja shëndetësore	23

Hyrje

„Të moshuarit në Kosovë 100 e më shumë vjeç” si i tille është hulumtim i parë i këtij lloji në Kosovë.

Hulumtimi paraqet disa karakteristika të kësaj kategorie mbi: jetëgjatësinë, mënyrën e jetesës, përdorimin e ushqimit, të dhëna tjera demografiko-shëndetësore, sociale, shtrirja territoriale-hapësinore dhe disa karakteristika tjera.

Hulumtimi njeherit tregon jetëgjatësinë në Kosove duke marrë për bazë kushtet dhe rrethanat në të cilat kanë jetuar dhe jetojnë kjo moshë e popullatës së Kosovës.

Në mungesë të të dhënave për këtë moshë për vitet e mëhershme nuk kemi arritur të bëjmë krahasime nëse në vitet e mëhershme ka pasur numër të caktuar të moshuarve mbi moshën 100 vjeçare, më disa karakteristika apo edhe nëse ka jetuar më shumë vite ndonjëri prej tyre.

Në këtë hulumtim janë marrë edhe disa të dhëna në nivel botëror për të pasur një pasqyrë krahasuese për këtë moshë të popullsisë.

Të dhënat janë marrë nga anëtarët e afërt të familjeve të të moshuarve. Të gjithë të vizituarve, u është kërkuar dokumentacioni valid nga ekipet e ESK, më pas janë evidencuar, dhe një pjesë të tyre u janë fotokopjuar apo fotografuar (dokumentet).

Të dhënat janë grumbulluar më anë të pyetësorëve duke zhvilluar intervistën drejtpërdrejt më personat e moshuar të kësaj moshe dhe anëtarët e afërm të familjeve.

Përpunimi dhe analizimi i këtyre të dhënave është bërë në bazë të të dhënave administrative, punës në terren dhe dëshmimeve e deklaratave që kanë zhvilluar ekipet e ESK-së.

Implementimi i projektit në fjalë, ka pasur vështirësi të caktuara dhe ka kërkuar një angazhim shtesë për realizimin e tij, duke angazhuar grupe punuese të caktuara për identifikimin, grumbullimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave.

Projekti është zhvilluar në mënyrë vullnetare nga personeli i ESK-së, pa përkrahje financiare, mjete stimuluese, pa logjistikë të mjaftueshme për zhvillimin aktivitetëve të këtij hulumtimi, ku, në shumë raste është dashur të punohet jashtë orarit të punës dhe ditëve të vikendit.

Edhe përkundër të këtyre vështirësive projekti është realizuar më sukses.

Për shkak të mungesës të një sistemi të avancuar statistikor, përkundër angazhimeve të personelit të ESK dhe sensibilizimit të popullsisë, mund të mos jetë i përfshirë ndonjë person që ka kaluar moshën 100 vjeç andaj, shprehim mirëkuptimin për lajmërimin dhe evidencimin e të gjithë personave të kësaj moshe më qëllim që të kemi një pasqyre të saktë të kësaj popullate.

Sistemi statistikor i Kosovës

Sistemet statistikore (Institutet statistikore) pothuaj në të gjitha vendet e botës janë ndërtuar në një shkallë të lartë të burimeve të informacioneve (nga regjistrimet e popullsisë, regjistrat e ndryshëm, të dhënave administrative apo hulumtimeve) lidhur me të dhënat socio-ekonomike, demografike, edukative, shëndetësore, bujqësore etj.

Sistemi i mirëfilltë informativ, ndihmon në ndërmarrjen e masave adekuate dhe krijimin e politikave të ndryshme socio-ekonomike në nivel lokal dhe në nivel vendi. Pothuaj asnjë plan në nivelin lokal në vendet e zhvilluara nuk bëhet pa të dhëna statistikore mbi atë dukuri apo fenomen, derisa, planet në nivel vendi nuk bëhen pa të dhëna të detajuara statistikore.

Për të zhvilluar një sistem të tillë nevojitet angazhim i madh i personelit dhe buxhetit me qëllim të krijimit të një baze të të dhënave statistikore të qëndrueshme për politikën zhvillimore të progresit shoqëror. Shekulli 21 nga shumë studiues dhe hulumtues quhet edhe *shekulli i informacionit*.

Statistika më informacionet e saja të sakta, të shpejta, dhe të lehta për shfrytëzim, zënë vend të rëndësishëm në një shtet sa që në disa shtete institutet statistikore janë edhe ministri në vete.

Kosova ende nuk ka një bazë të tillë të të dhënave statistikore e cila do ti ndihmonte si qeverisë së Kosovës, institucioneve tjera qeveritare, joqeveritare, shkencëtarëve, hulumtuesve, individëve organizatave ndërkombëtare etj, për krijimin e politikave socio-ekonomike.

Investimet që i ka bërë shoqëria Kosovare në ngritjen e sistemit statistikor, Kosova qëndron shumë më mbrapa se shumë vende në regjion. Kështu, derisa këto vende investojnë duke filluar nga 1 deri 3 € e më shumë, Kosova në 2 vitet e fundit ka investuar vetëm 0.24 € për kokë banori.

Në shtetet Evropiane, mesatarisht një statisticient është i paraparë në 4.000 deri 6.000 banorë, ndërsa në Kosovë kjo mesatare është në çdo 18,650 banorë. Kjo le të kuptohet se sistemit statistikor në Kosovë i është kushtuar pak vëmendje.

Kosova në ndërtimin e sistemit statistikor dhe hulumtimet që i zhvillon ka pak ngecje sa i përket vendeve të rajonit (nëse krahasohen hulumtimet statistikore), por kjo ngecje rrjedhë si pasojë e mungesës së burimeve të mangëta administrative më të cilat shërbehet ESK.

Një fakt tjetër që ka përcjellur këto vite të tëra ESK-në është edhe mosinteresimi në masë të shprehur i shoqërisë, për të dhëna statistikore dhe orientimi për tu shërbyer nga burime të tjera informative të cilat në të shumtën e rasteve i shfrytëzojnë të dhënat nga ESK.

Enti i Statistikës së Kosovës, grumbullon, përpunon, analizon dhe publikon të dhëna statistikore nga fushat e ndryshme : ekonomike, të popullsisë, sociale, bujqësore, edukative, shëndetësore etj.

ESK po bënë përpjekje maksimale të ketë një sistem statistikor të qëndrueshëm përkundër vështirësive që janë paraqitur deri tani.

Edhe pse në mungesë të buxhetit dhe personelit të mjaftueshëm, ESK më kapacitetet që posedon ka arritur të ngrit kualitetin e të dhënave dhe shtimin e numrit të hulumtimeve statistikore në një masë të konsiderueshme.

Kështu, gjatë këtij viti ESK ka organizuar tri hulumtime të reja statistikore të cilat nuk kanë qenë në programin vjetor të hulumtimeve statistikore. Të gjitha këto kanë koston e vetë për tu implementuar. *Për realizimin e një hulumtimi të ri statistikor është vlerësuar (varësisht nga volumi i hulumtimit statistikor)se nevojiten 30-50 mijë €.*

Një prej hulumtimeve të reja gjatë këtij viti është edhe hulumtimi „**Të moshuarit në Kosovë 100 e më shumë vjeç**” i cili si i tillë është hulumtim i parë i këtij lloji që bëhet në Kosovë. *Hulumtimi është paraparë të realizohet në çdo 5 vite.*

Qëllimi i hulumtimit

Duke pasur disa informata paraprake për personat 100 e më shumë vjeç dhe interesimin e opinionit kosovar për këtë moshë, ESK ka marrë iniciativën për organizimin, zbatimin dhe realizimin e këtij hulumtimi.

Hulumtimi ka për qëllim sensibilizimin e shoqërisë kosovare për jetëgjatësinë e mundshme dhe të arritshme në kushtet e sotme në Kosovë, ndikimit të kushteve natyrore, atyre trashëguese, kushteve dhe rrethanave shoqërore.

Pasqyra tabelare e dhënë në këtë hulumtim për personat e kësaj moshe do tu mundësoj hulumtueseve të ndryshëm të njoftohen nga këta persona për mënyrën e jetesës dhe arritjes së jetëgjatësisë deri në moshën në të cilën kanë arritur të jetojnë ky grup i popullsisë.

Po ashtu hulumtimi ka për qëllim sensibilizimin e institucioneve dhe qeverisë për mënyrën e jetesës së kësaj kategorie të të moshuarve, për të ndërmarrë masa në krijimin e kushteve më të mira të jetesës për këtë kategori të popullsisë.

Edhe në shoqëritë e zhvilluara bëhen hulumtime statistikore të tilla, për të nxjerrë të dhëna për popullatën 100 e më shumë vjeçe, në aspektin e jetëgjatësisë dhe kërkime e analiza të tjera hulumtuese në aspektin social dhe shëndetësor.

Disa shtete (organizatat dhe qeveritë) gjatë vitit organizojnë takime të veçanta më personat 100 e më shumë vjeç, pasi llogaritën si pasuri socialo-shëndetësore, ku i jepet hapësirë e madhe mediale, iu dërgohen dhurata të veçanta, mjete financiare dhe beneficione tjera shtesë nga shoqëria, krahasuar më personat tjerë nën këtë moshë.

Andaj, shpresojmë që edhe vendi ynë të ketë një qasje të mirë për këta persona dhe njeherit të krijoj kushte më të mira të jetesës.

Propozojmë që çdo vit të organizohet një takim mikpritës nga institucionet e shoqërisë kosovare më të gjithë ata që janë në këtë moshe, duke i mbështetur dhe përkrahur në disa aspekte, pasi të gjithë janë persona të mbajtur.

Sipas të dhënave të marra nga terreni nga grupet punuese të ESK , pjesa dërmuese e personave 100 e më shumë vjeç, janë nën kujdesin e anëtarëve të familjes, më kushte të mira të jetesës, derisa një pjese nuk kanë kushte të mira për jetesë, është shumë e nevojshme një mbështetje nga shoqëria.

Metodologjia

Janë mbajtur disa takime paraprake për mënyrën e implementimit të këtij projekti nga ESK, është përpiluar metodologjia e hulumtimit, instrumentet e nevojshme, plani operacional për të realizuar këtë hulumtim duke formuar grupet e caktuara punuese, janë përzgjedhur personat që kanë përvojë më hulumtime statistikore.

ESK, ka përpiluar *Pyetësorin* individual statistikor për të moshuarit më gjithsej 15 pyetje, ka hartuar një *Udhëzim* të shkurtër për plotësimin e pyetësorit dhe për qasjen e hulumtimit në të cilën janë paraparë kriteret për evidentimin e të gjithë personave të moshës 100 e më shumë vjeç, në tërë territorin e Kosovës, pa dallim gjinie, etniciteti, ngjyre apo feje.

Paraprakisht janë marr disa baza të të dhënave nga MPB, MPMS, shumë zyre të ofiqarive, si dhe informata nga zyrat regjionale statistikore, grupeve të ndryshme dhe individëve.

Është bërë sensibilizimi i popullsisë përmes reklamës televizive në RTK dhe web faqes zyrtare të ESK, sensibilizim ky i cili ka ndikuar në paraqitjen rasteve nga ana e familjarëve dhe të tjerëve për të moshuarit 100 e më shumë vjeç.

Në anën tjetër, edhe pse disa familjar janë deklaruar që disa persona mund të jenë mbi moshën 100 vjeçare, pas intervistimit dhe verifikimit të dokumentacionit valid, është vërtetuar se nuk i plotësojnë kriteriumet e parapara për këtë hulumtim.

Personat e shumtë që kanë figuruar si persona të gjallë (nga burimet që ka poseduar ESK) , në terren është vërtetuar se nuk jetojnë e që një pjesë e tyre kishin vdekur edhe disa vite më parë.

Një problem shtesë i paraqitur ka qenë identifikimi i personave në terren pasi nga popullsia e asaj zone është deklaruar se nuk kishin dëgjuar asnjëherë më parë për ata persona që kishin figuruar në burimet që posedonte ESK-ja.

Po ashtu ndërrimi i vendbanimit (krahasuar më informatat që i kemi poseduar) ka ndikuar në kohëzgjatjen e këtij projekti që të realizohet në kohë të caktuar.

Intervistuesit e ESK kanë qenë të obliguar të vërtetojnë më ndonjë dokument valid nëse personi ka 100 e më shumë vite, ku ka figuruar emri, mbiemri, data dhe viti i lindjes, në bazë të deklaratave të të moshuarve apo të afërmve të tyre që janë deklaruar për moshën e tyre.

Vlen të theksohet se 2 persona edhe pse kanë pasur dokumente valide mbi moshën 100 vjeçare, në baze të deklaratave të personave të afërm dhe vetë të të moshuarve është vërtetuar se nuk kanë moshën e duhur për tu përfshirë në këtë hulumtim.

Më pas është bërë mbledhja, klasifikimi, verifikimi, analizimi, dhe tabelimi i të dhënave që janë paraqitur më anë të tabelave, grafikoneve dhe hartave në këtë hulumtim.

Koha e realizimit të hulumtimit

Projekti në terren është realizuar gjatë periudhës maj - nëntor, 2007. Kohëzgjatja e punës në terren, vizitës së të moshuarve në vendin e banimit, verifikimin e të gjitha të dhënave të marra nga burimet e ndryshme dhe zhvillimi i intervistës, ka marrë kohë më shumë se është paraparë, pasi është dashur të mbulohet i tërë territori i Kosovës. Në anën tjetër ESK ka pasur aktivitet e veta të parapara më planin vjetor gjatë këtij viti që është dashur të realizohen.

Disa të dhëna mbi jetëgjatësinë në nivelin botëror

Jetëgjatësia mesatare në nivelin botëror sillet rreth 67 vite.

Në bazë të disa hulumtimeve që janë bërë deri më tani nga shkencëtarët e ndryshëm besohet se periudha e njeriut të hershem kishte një jetëgjatësi shumë të shkurtër.

Jetëgjatësia varej prej kushteve të jetës, ndikimit të kushteve të klimatike, sëmundjeve të ndryshme, luftërave fisnore dhe faktorëve të tjerë që janë paraqitë gjatë periudhave të ndryshme kohore. Kështu, lloji i Neandertalit jetoi mesatarisht rreth 20 vite, në Paleolitin e lartë kishte një jetëgjatësi mesatare prej 33 vite, më pas bie mesatarja e jetëgjatësisë. Shih tabelën e mëposhtme.

Periudhat kohore	Mesatarja e jetëgjatësisë
Neandertali	20
Paleoliku i lartë	33
Neoliti	20
Bronzit	18
Periudha Greke	20-30
Periudha Romake	20-30
Para Kolumbiane (para viteve 1500)	25-35
Shekulli XV-XVII	35
Fillimi i shekullit 20	40
Mesatarja e tanishme-niveli botëror	67

Më përmirësimin e kushteve të jetesës, zhvillimin e shoqërisë dhe standardit jetësor është rritur mesatarja e jetëgjatësisë së njeriut nëpër periudha të ndryshme kohore.

Kjo ndryshon nga niveli dhe kushtet e jetesës dhe nga ndikimi i faktorëve tjerë nga vendi në vend. Shih tabelën e jetëgjatësisë në botë.

Të moshuarit në Kosovë mbi 100 e më shumë vjeç

Jetegjatesia mesatare-meshkujve dhe femrave sipas shteteve																			
Renditja	Vendi/territori	Mesatarja	Meshkuj	Femra	Renditja	Vendi/territori	Mesatarja	Meshkuj	Femra	Renditja	Vendi/territori	Mesatarja	Meshkuj	Femra	Renditja	Vendi/territori	Mesatarja	Meshkuj	Femra
	Mesatarja botërore	67.2	65	70		Mesatarja botërore	67.2	65	70		Mesatarja botërore	67.2	65	69.5		Mesatarja botërore	67.2	65	70
1	Japonia	82.6	79	86.1	51	Guiana Franceze	75.9	72.5	79.9	101	Kepi i Bleritë	71.7	68.3	74.5	149	Mianmar	62.1	59	65.3
2	Hong Kongu	82.2	79.4	85.1	52	Kroacia	75.7	72.3	79.2	102	Shën Vinsenti	71.6	69.5	73.8	150	Haiti	60.9	59.1	62.8
3	Islanda	81.8	80.2	83.3	53	Omani	75.6	74.2	77.5	103	Samoa	71.5	68.5	74.8	151	Timori Lindor	60.8	60	61.7
4	Zvicra	81.7	79	84.2	54	Bahrain	75.6	74.3	77.5	104	Peru	71.4	68.9	74	152	Gana	60	59.6	60.5
5	Australia	81.2	78.9	83.6	55	Katar	75.6	75.2	76.4	105	Estonia	71.4	65.9	76.8	153	Kamboxha	59.7	57.3	61.9
6	Spanja	80.9	77.7	84.2	56	Polonia	75.6	71.3	79.8	106	Egjipti	71.3	69.1	73.6	154	Irak	59.5	57.8	61.5
7	Suedia	80.9	78.7	83	57	Panama	75.5	73	78.2	107	Maroko	71.2	69	73.4	155	Gambia	59.4	58.6	60.3
8	Izraeli	80.7	78.5	82.8	58	Guam (SHBA)	75.5	73.3	77.9	108	Gjeorgjia	71	67.1	74.8	156	Madagaskar	59.4	57.7	61.3
9	Makao	80.7	78.5	82.8	59	Argjentina	75.3	71.6	79.1	109	Irani	71	69.4	72.6	157	Sudan	58.6	57.1	60.1
10	Franca	80.7	77.1	84.1	60	Antila H.	75.1	71.3	78.8	110	Indonezia	70.7	68.7	72.7	158	Togo	58.4	56.7	60.1
11	Kanada	80.7	78.3	82.9	61	Ekuadori	75	72.1	78	111	Tailanda	70.6	66.5	75	159	Eritrea	58	55.6	60.3
12	Italia	80.5	77.5	83.5	62	Bosnja.H	74.9	72.2	77.4	112	Guatemala	70.3	66.7	73.8	160	Guinea e Re	57.2	54.6	60.4
13	Zelanda e Re	80.2	78.2	82.2	63	Slovakia	74.7	70.7	78.5	113	Surinami	70.2	67	73.6	161	Nigeria	56.9	57.8	56
14	Norvegjia	80.2	77.8	82.5	64	Mali i Zi	74.5	72.4	76.8	114	Hondurasi	70.2	66.9	73.7	162	Gabon	56.7	56.4	57.1
15	Singapori	80	78	81.9	65	Vietnami	74.2	72.3	76.2	115	Vanuatu	70	68.3	72.1	163	Benin	56.7	55.6	57.8
16	Austria	79.8	76.9	82.6	66	Malaizia	74.2	72	76.7	116	T. Tobago	69.8	67.8	71.8	164	Guinea	56	54.4	57.6
17	Holanda	79.8	77.5	81.9	67	Aruba(Holand.)	74.2	71.3	77.1	117	Bellorusia	69	63.1	75.2	165	R.Kongo	55.3	54	56.6
18	Martini	79.5	76.5	82.3	68	Maqedonia	74.2	71.8	76.6	118	KOSOVA	69	67	71	166	Xhibuti	54.8	53.6	56
19	Greqia	79.5	77.1	81.9	69	Siria	74.1	72.3	76.1	119	Moldavia	68.9	65.1	72.5	167	Mali	54.5	52.1	56.6
20	Belgjika	79.4	76.5	82.3	70	Pol. Franceze	74.1	71.7	76.8	120	Figji	68.8	66.6	71.1	168	Kenia	54.1	53	55.2
21	Malta	79.4	77.3	81.3	71	Serbia	74	71.7	76.3	121	Grenada	68.7	67	70.3	169	Etiopia	52.9	51.7	54.3
22	Anglia	79.4	77.2	81.6	72	Libia	74	71.7	76.9	122	Mikronezia	68.5	67.7	69.3	170	Namibia	52.9	52.5	53.1
23	Gjermania	79.4	76.5	82.1	73	Tunizia	73.9	71.9	76	123	Maldavive	68.5	67.6	69.5	171	Tanzania	52.5	51.4	53.6
24	Ish.Virgjin	79.4	75.5	83.3	74	Venezuela	73.7	70.9	76.8	124	Ukraina	67.9	62.1	73.8	172	Burkina Faso	52.3	50.7	53.8
25	Finlanda	79.3	76.1	82.4	75	Shën Lucia	73.7	71.8	75.6	125	Azerbaixhan	67.5	63.8	71.2	173	Guinea Ekuat.	51.6	50.4	52.8
26	Guadalupe	79.2	76	82.2	76	Bahama	73.5	70.6	76.3	126	Korea Veriut	67.3	65.1	69.3	174	Uganda	51.5	50.8	52.2
27	Ishujt Kanal	79	76.6	81.5	77	Palestina	73.4	71.8	75	127	Uzbekistani	67.2	64	70.4	175	Botsuana	50.7	50.5	50.7
28	Qipro	79	76.5	81.6	78	Hungaria	73.3	69.2	77.4	128	Kazahstani	67	61.6	72.4	176	Çad	50.6	49.3	52
29	Irlanda	78.9	76.5	81.3	79	Tonga	73.3	72.3	74.3	129	Guiana	66.8	64.2	69.9	177	Kameron	50.4	50	50.8
30	Kosta Rika	78.8	76.5	81.2	80	Bullgaria	73	69.5	76.7	130	Mongolia	66.8	63.9	69.9	178	Burundi	49.6	48.1	51
31	Porto Riko	78.7	74.7	82.7	81	Lituania	73	67.5	78.3	131	Taxhikistan	66.7	64.1	69.4	179	Afrika Jugore	49.3	48.8	49.7
32	Luksemburg	78.7	75.7	81.6	82	Kina	73	71.3	74.8	132	Sahara Perënd.	65.9	64.3	68.1	180	Côte d'Ivoire	48.3	47.5	49.3
33	Em.B. Arabe	78.7	77.2	81.5	83	Nikaragua	72.9	69.9	76	133	Kirgistan	65.9	62	69.9	181	Malai	48.3	48.1	48.4
34	Korea Jugut	78.6	75	82.2	84	Kolumbia	72.9	69.2	76.6	134	Butan	65.6	64	67.5	182	Somalia	48.2	46.9	49.4
35	Kili	78.6	75.5	81.5	85	Mauritis	72.8	69.5	76.2	135	Bolivia	65.6	63.4	67.7	183	Nigeria	46.9	46.4	47.3
36	Danimarka	78.3	76	80.6	86	Arabia Saudite	72.8	70.9	75.3	136	S.T.Principe	65.5	63.6	67.4	184	R.D. e Kongos	46.5	45.2	47.7
37	Kuba	78.3	76.2	80.4	87	Letonia	72.7	67.3	77.7	137	Pakistani	65.5	65.2	65.8	185	Guinea-Bisau	46.4	44.9	47.9
38	SHBA	78.2	75.6	80.8	88	Xhamaika	72.6	70	75.2	138	Rusia	65.5	59	72.6	186	Ruanda	46.2	44.6	47.8
39	Portugalia	78.1	75	81.2	89	Jordani	72.5	70.8	74.5	139	Komoros	65.2	63	67.4	187	Liberia	45.7	44.8	46.6
40	Slovenia	77.9	74.1	81.5	90	Rumania	72.5	69	76.1	140	India	64.7	63.2	66.4	188	Rep.Afrikane	44.7	43.3	46.1
41	Kuwait	77.6	76	79.9	91	Shri Lanka	72.4	68.8	76.2	141	Laos	64.4	63	65.8	189	Afgjanistani	43.8	43.9	43.8
42	Barbados	77.3	74.4	79.8	92	Brazili	72.4	68.8	76.1	142	Mauritania	64.2	62.4	66	190	Zimbabve	43.5	44.1	42.6
43	Brunei	77.1	75	79.7	93	Algjeria	72.3	70.9	73.7	143	Bangladesh	64.1	63.2	65	191	Angola	42.7	41.2	44.3
44	Republika Çeke	76.5	73.4	79.5	94	Republika Dom	72.2	69.3	75.5	144	Nepal	63.8	63.2	64.2	192	Lesoto	42.6	42.9	42.3
45	Reunion	76.4	72.3	80.5	95	Libani	72	69.9	74.2	145	Ishujt Solomon	63.6	62.7	64.5	193	Siera Leone	42.6	41	44.1
46	Shqipëria	76.4	73.4	80	96	Armenia	72	68.4	75.1	146	Turkmenistan	63.2	59	67.5	194	Zambia	42.4	42.1	42.5
47	Uruguai	76.4	72.8	79.9	97	El Salvador	71.9	68.8	74.9	147	Senegal	63.1	61	65.1	195	Mozambiku	42.1	41.7	42.4
48	Meksiko	76.2	73.7	78.6	98	Turqia	71.8	69.4	74.3	148	Jemen	62.7	61.1	64.3	196	Suaziland	39.6	39.8	39.4
49	Belize	76.1	73.3	79.2	99	Paraguai	71.8	69.7	73.9										
50	Kaledonia e Re	76.1	72.8	79.7	100	Filipinet	71.7	69.5	73.9										

Nga të dhënat shohim se jetëgjatësinë mesatare më të gjatë në botë e mbanë Japonia më 82.6 vite.

Kosova në nivelin botëror renditet e 118-ta më jetëgjatësi mesatare prej 69 vite (meshkujt 67 dhe femrat më 71) derisa, Shqipëria është në vendin e 46-të më jetëgjatësi mesatare prej 76.4 vite (meshkujt më 73 dhe femrat më 79.7 - vite).

Hulumtuesit dhe shkencëtarët të cilët merren më jetëgjatësinë e njerëzimit për shekullin 21 vlerësojnë se: vetëm një person në 100 mije banorë mund të jetojë më shumë se 100 vite, derisa prej tyre vetëm një mund të ketë mbi 110 vite, gjersa prej 5.000 të moshuarve mbi moshën 110 vite vetëm një ka mundësi të jetoj 120 vite.

Sipas të dhënave statistikore dhe ato shëndetësore personi që ka jetuar më së gjati deri më sot është nga Franca, Jeanne Calmënt (femër) e cila ka lindur më 21 shkurt 1875 dhe ka jetuar deri në vitin 1997 (04 gusht) e që llogaritet se ka jetuar 122 vite e 164 ditë, njeherit e regjistruar edhe në librin e Ginisit si personi që ka jetuar më së gjati. Kishte pesë fëmijë ku tre prej tyre ende jetojnë: Irma dhe Hilda 81, dhe djali Anibal, 77 vite.

Emiliano Mërcado Del Toro, nga Puerto Rico, mban titullin si mashkulli që ka jetuar më së gjati 114 vite.

Personat më të vjetër në vitin 2007 konsiderohen Edna Parker nga SHBA e lindur më 20 prill 1893 dhe Maria de Jesus e lindur më 10 shtator 1893 në Portugali pra, nga 114 - vite.

Mashkulli që ka vite më së shumti dhe që jeton ende është Tomoji Tanabe nga Japonia që ka 112 vite (i lindur më 18 shtator 1895).

Më të moshuarit në botë

Në tabelën e mëposhtme është dhënë lista e njëzet personave më të moshuar në botë: sipas moshës, datës se lindjes si dhe vendbanimit rezident .

Njëzet personat më të vjetër që ende jetojnë

Nr	Emri, mbiemri	Mosha	Lindur	Rezident (jetojnë)
1	Edna Parker	114 vite, 227 ditë	20 Prill, 1893	SHBA, Indiana
2	Maria de Jesus	114 vite, 84 ditë	10, shtator, 1893	Portugal, Santarém
3	Arbella Ewing	113 vite, 265 ditë	13, mars, 1894	SHBA, Tëxas
4	Gertrude Bainës	113 vite, 241 ditë	6, prill, 1894	SHBA, California
5	Tsunëyo Toyonaga	113 vite, 196 ditë	21, maj, 1894	Japoni, Kochi
6	Clémëntinë Solignac	113 vite, 87 ditë	7, shtator, 1894	Franc, Auvergnë
7	Leila Backman Shull	113 vite, 48 ditë	16, tetor, 1894	SHBA, Karolina e Jugut
8	Catherinë Hagel	113 vite, 5 ditë	28, nëntor, 1894	SHBA, Minnësota
9	Kaku Yamanaka	112 vite, 357 ditë	11, dhjetor, 1894	Japoni, Aichi
10	Beatrice Farve	112 vite, 217 ditë	30, prill, 1895	SHBA
11	Tomoji Tanabe	112 vite, 76 ditë	18, shtator, 1895	Japoni
12	Henry Allingham	111 vite, 180 ditë	6, qërshor, 1896	Angli
13	George Francis	111 vite, 180 ditë	6, qërshor, 1896	California, SHBA
14	Waltër Breuning	111 vite, 73 ditë	21, shtator 1896	Montana, SHBA
15	Augusto de Oliveira	111 vite, 58 ditë	6, tetor 1896	Portugali
16	Waltër Seward	111 vite, 51 ditë	13, tetor, 1896	Nëw Jersey, SHBA
17	Nicholas Kao Se Tseien	110 vite, 322 ditë	15, janar, 1897	Hong Kong, Kina
18	Jiroemon Kimura	110 vite, 228 ditë	19, prill, 1897	Japoni, Kyoto
19	Kiyoshi Igarashi	110 vite, 123 ditë	2, gusht, 1897	Japoni, Hokkaidō
20	Aarnë Arvonën	110 vite, 121 ditë	4, gusht, 1897	Finlanda, Uusimaa

Të moshuarit mbi 100 e më shumë vjeç në Kosovë

Jetëgjatësia mesatare në Kosovë është vlerësuar të jetë rreth 69 vite. Për meshkuj 67 dhe për femra 71 vite.

Të dhënat paraprake kanë qenë befasuese për numrin e personave mbi moshën 100 vjeçare nga burimet që ka poseduar ESK.

Pas verifikimit të të dhënave në terren del se Kosova kishte një numër më të vogël krahasuar me listat paraprake, por në anën tjetër nëse krahasohet më jetëgjatësinë në nivelin botëror, ku në 100 mijë banorë jeton një person mbi 100 vite (apo në 1 milion banorë jetojnë 10 persona), në Kosovë jetëgjatësia sipas këtyre të dhënave është më e madhe se mesatarja e botës.

Pasi si kriter për përfshirje në këtë hulumtim ka qenë një dokument valid dhe deklarata e drejtpërdrejt nga të moshuarit apo anëtarët e afërm tjerë të familjes që kanë ndihmuar në dhënien e informatave të duhura le të kuptohet se numri i personave është i besueshëm.

Pas analizimit të të dhënave të marra nga burimet e ndryshme shihet se Kosova ka një numër të shprehur të popullsisë që ka kaluar moshën 100 e më shumë vjeç.

Numri i personave që kanë kaluar një shekull jetë në Kosovë në baze të të dhënave është **73 persona**.

Në Kosovë sipas këtyre të dhënave në çdo 34,250 banorë vie një i moshuar mbi moshën 100 vjeçare.

Disa karakteristika në Kosovë për të moshuarit mbi 100 vjeç

Të moshuarit sipas regjioneve (ndarje statistikore)


Nëse shikohet si regjion (shtatë të tilla) shohim, se Prizreni ka numrin më të madh të të moshuarve më 17-sish apo 23.3%, më pas Prishtina më 13 apo 17.8%, Peja e Gjakova më nga 9 persona apo 12.3%.

Regjioni	Gjithsej	
Prizren	17	23.3
Prishtinë	13	17.8
Ferizaj	10	13.7
Gjakovë	9	12.3
Pejë	9	12.3
Mitrovicë	8	11
Gjilani	7	9.6
Gjithsej	73	100

Shtrirja territoriale e të moshuarve sipas komunave

Nga gjithsej 30 komuna sa janë në Kosovë në nëntë prej tyre, nuk kemi hasur persona mbi moshën 100 vjeç: Leposaviq, Shtërpcë, Zubin Potok, Zveçan, Istog, Novobërdë, Obiliq, Rahovec dhe Viti.

Koncentrimi më i madh i të moshuarve në nivel të Kosovës ishte në komunën e Prizrenit me 10 persona apo me 13.7% mbi moshën 100 vjeçare, pastaj Kaçaniku me 7 apo 9.6, Deçani, Peja dhe Vushtrri me 6 apo 8.2 % persona.



Pjesëmarrja e të moshuarve sipas vendqëndrimit të përhershëm


Nga të dhënat shohim se pjesëmarrjen më të madhe në nivel të Kosovës e ka Prizreni më 13.7%, pastaj Kaçaniku më 9.6%, Vushtrria, Peja dhe Deçani më nga 8.2% të të moshuarve mbi moshën 100 vjeçare.

Kodi	Emertimi i komunës	Numri i të moshuarve ne komuna	Pjesmarrja e të moshuarve sipas vendqendrimit (%)
1	Prizreni	10	13,7
2	Kaçaniku	7	9,6
3	Deçani	6	8,2
4	Peja	6	8,2
5	Vushtrria	6	8,2
6	Glllogoci	5	6,8
7	Ferizaj	5	6,8
8	Prishtina	4	5,5
9	Suhareka	4	5,5
10	Gjakova	3	4,1
11	Gjilani	2	2,7
12	Kamenica	2	2,7
13	Mitrovica	2	2,7
14	Lipjani	2	2,7
15	Skenderaj	2	2,7
16	Malisheva	2	2,7
17	Dragashi	1	1,4
18	Klina	1	1,4
19	Fushë Kosova	1	1,4
20	Podujeva	1	1,4
21	Shtime	1	1,4
22	Istogu	0	0
23	Leposaviqi	0	0
24	Novobërda	0	0
25	Obiliqi	0	0
26	Rahoveci	0	0
27	Shtërpca	0	0
28	Vitia	0	0
29	Z.Potoku	0	0
30	Zveçani	0	0
Gjithsej		73	100

Pjesëmarrja e të moshuarve në 100 mijë banorë

Pjesëmarrjen më të madhe të të moshuarve krahasuar më numrin e popullsisë në komunë e kishte: Kaçaniku më 18.5 banore pastaj Deçani më 12.3 dhe Glogoci më 9.4. Pjesëmarrjen më të vogël (përveç atyre që nuk kanë të moshuar mbi moshën 100 vjeçare) e kishin: Prishtina më 1 , Podujeva 1.2 dhe Gjlani më 1.9 banore.

Te moshuarit neper komuna dhe pjesëmarrja e tyre ne 100 000 banore		
Kodi	Emertimi I komunave	Pjesëmarrja në 100 000 banorë
1	Kaçaniku	18,5
2	Deçani	12,6
3	Glogoci	9,4
4	Vushtrria	7,7
5	Suhareka	6,1
6	Prizreni	5,6
7	Ferizaj	4,8
8	Peja	4,6
9	Malisheva	4,3
10	Shtime	4,2
11	Skenderaj	3,9
12	Kamenica	3,8
13	Fushë Kosova	3
14	Lipjani	2,9
15	Gjakova	2,6
16	Dragashi	2,5
17	Klina	2,1
18	Mitrovica	2,1
19	Gjlani	1,9
20	Podujeva	1,2
21	Prishtina	1
22	Istogu	0
23	Leposaviqi	0
24	Novobërda	0
25	Obiliqi	0
26	Rahoveci	0
27	Shtërpca	0
28	Vitia	0
29	Z.Potoku	0
30	Zveçani	0



Të moshuarit sipas vendqëndrimit dhe komunës së lindjes

Nga të dhënat shohim se 8 persona apo 11.0% e këtyre të moshuarve janë të lindur jashtë Kosovës (kjo dukuri zakonisht është të femrat të cilat janë të martuara në Kosovë).

Në komunat Istog, Rahovec dhe Viti ka persona të lindur të kësaj moshe, por që tani nuk jetojnë në ato komuna.

Emërtimi i komunave	Vendqëndrimi	Komuna e lindjes
Deçani	8.2	6.8
Gjakova	4.1	1.4
Glogoci	6.8	4.1
Gjilani	2.7	2.7
Dragashi	1.4	1.4
Istogu	0.0	1.4
Kaçaniku	9.6	6.8
Klina	1.4	1.4
Fushë Kosova	1.4	2.7
Kamenica	2.7	4.1
Mitrovica	2.7	4.1
Leposaviqi	0.0	0.0
Lipjani	2.7	4.1
Novobërda	0.0	0.0
Obiliqi	0.0	0.0
Rahoveci	0.0	1.4
Peja	8.2	4.1
Podujeva	1.4	4.1
Pristina	5.5	2.7
Prizreni	13.7	16.4
Skenderaj	2.7	1.4
Shtimë	1.4	1.4
Shtërpca	0.0	0.0
Suhareka	5.5	4.1
Ferizaj	6.8	5.5
Vitia	0.0	1.4
Vushtrria	8.2	4.1
Zubin Potoku	0.0	0.0
Zveçani	0.0	0.0
Malisheva	2.7	1.4
Jashtë Kosove	0.0	11.0

Lista e personave më të moshuar në Kosovë

Në tabelën e mëposhtme është dhënë lista e personave më të moshuar në Kosove sipas vendit të lindjes dhe vendqëndrimit të përhershëm


Nr.	Emri, dhe mbiemri	Vendlindja	Komuna	Vendi i qendrimit	Komuna	Mosha
1	Feride Bucolli	Strovc	Vushtri	Poklek i Vjetër	Glllogoc	108
2	Fazile Tahiri	Kaqanoll	Mitrovicë	Selac	Mitrovicë	108
3	Zyle Krasniqi	Shalinovicë	Istog	Pejë	Pejë	108
4	Ajmane Hasana	Strelle i Epërm	Deçan	Strelle i Ulët	Deçan	107
5	Hafije Emini	Bresalc	Gjilan	Zhegër	Gjilan	107
6	Fikrije Berisha	Kaçanik	Kaçanik	Runievë	Kaçanik	107
7	Sylë Tahiri	Shahiq	Kamenicë	Shahiq	Kamenicë	107
8	Bahtije Qehaja	Polickë	Kamenicë	Hodonoc	Kamenicë	107
9	Nurije Krasniqi	Hogë e Qytetit	Prizren	Hogë e Qytetit	Prizren	107
10	Hamide Ferati	Tërn	Ferizaj	Shtime	Shtime	107
11	Hyra Fejza	Maxher	Mitrovicë	Këçi i Madh	Mitrovicë	107
12	Hajrije Berisha	Strofc	Vushtri	Bivolak	Vushtri	107
13	Hateme Morina	Radost	Rahovec	Radostë	Rahovec	107
14	Xhevë Zulfaj	Novosellë	Prizren	Senik	Malishevë	107
15	Zylfije Vesiqi	Zborc	Shtime	Ribar i Madhe	Lipjanit	107
16	Halime Rama	Samadregj	Vushtri	Mazhiq	Mitrovicë	106
17	Azem Dakaj	Kabash	Prizren	Kabash	Prizren	106
18	Huma Alija	Zhur	Prizren	Sallagrazhde	Suharekë	106
19	Hatmane Ferizaj	Isnqi	Deçan	Beleg	Deçan	105
20	Nazif Ademaj	Petrovë	Shtime	Petrovë	Shtime	105
21	Zylfije Ramishi	Budrikë	Gjilan	Ferizaj	Ferizaj	105
22	Azemine Mazreku	Billacë	Suharekë	Malishevë	Malishevë	105
23	Sherife Hykolli	Llapushnik	Glllogoc	Kishnarekë	Glllogoc	104
24	Sahit Sylja	Gllamnik	Podujevë	Gllamnik	Podujevë	104
25	Sala Ejupi	Sharban	Prishtinë	Prishtinë	Prishtinë	104
26	Sofe Mataj	Strelle i Poshtëm	Deçan	Pobërxhë	Deçan	104
27	Hatmane Alidemaj	Pozhar	Deçan	Prilep	Deçan	104
28	Hazir Matoshi	Gëmicë	Kamenicë	Gëmicë	Kamenicë	103
29	Hava Ahmetaj	Korish	Prizren	Korishë	Prizren	103
30	Salije Memaj	Zhur	Prizren	Zhur	Prizren	103
31	Hana Gegaj	Gjinaj	Kukës-Shqiperi	Sallagrazhde	Suharekë	103
32	Xhezide Bajrami	Komogllavë	Ferizaj	Zllatar	Ferizaj	103
33	Hysnije Zariqi	Nerodime	Ferizaj	Rahovicë	Ferizaj	103
34	Tahire Bytyqi	Gadime	Lipjan	Mirosalë	Ferizaj	103
35	Rrahime Gallopeni	Gjinovc	Suharekë	Dobërdolan	Suharekë	103
36	Cube Berisha	Fierzë	Fierzë-Shqiperi	Ramoc	Orize	102
37	Sherife Bytyqi	Mleqan	Malishevë	Arlat	Glllogoc	102
38	Smake Munishi	Tërstenik	Glllogoc	Tërstenik	Glllogoc	102
39	Nazmije Berisha	Kaçanik	Kaçanik	Runievë	Kaçanik	102
40	Nazmi Demnika	Komogllavë	Ferizaj	Sopponicë	Kaçanik	102
41	Zake Kelmendi	Dugajevë	Pejë	Dugajevë	Pejë	102
42	Hajrija Housiq	Kolloleq	Rozhajë	Kolloleq	Rozhajë	102
43	Selvije Ademaj	Vërmicë	Prizren	Zhur	Prizren	102
44	Nazife Barani	Greikoc	Suharekë	Klinë e Epërme	Skenderaj	102
45	Hava Sadrija	Bellopojë	Podujevë	Dumnicë e Poshtme	Vushtri	102
46	Muharrem Merovci	Mirovc	Podujevë	Samadrexhë	Vushtri	102
47	Nazlije Kicaj	Delloc	Suharekë	Grejoc	Suharekë	102
48	Kadire Krasniqi	Caparc	Prizren	Nashec	Prizren	102
49	Huma Seferaj	Kushnin Has	Prizren	Lubizhdë Has	Prizren	102
50	Ajshe Rraci	Turjak	Malishevë	Siqevë	Klinë	102
51	Gjylshahe Krasniqi	Glllogjan	Deçan	Dubovik	Deçan	102
52	Ajne Rexhepi	Tropojë	Tropojë	Babaj Boks	Gjakovë	102
53	Fatime Ahmeti	Svirçë	Medvegje	Krileve	Kamenice	102
54	Tahire Sinani	Abri e Epërme	Glllogoc	Nekoc	Glllogoc	101
55	Nexharije Shaqiri	Livoç i Ulët	Gjilan	Malishevë	Gjilan	101
56	Bajram Dumani	Miradi e Epërme	Fushë Kosovë	Miradi e Ulët	Fushë Kosovë	101
57	Selime Gashi	Bregu i Zi	Lipjan	Vrellë	Lipjan	101
58	Hasan Nikçi	Rekë e Allagës	Pejë	Rekë e Allagës	Pejë	101
59	Hatmane Krasniqi	Kliqinë	Pejë	Kliqinë	Pejë	101
60	Fetije Çupi	Billacë	Maqedoni	Paldenicë	Kaçanik	101
61	Miradije Topalli	Prushaj	Kaçanik	Sopponicë	Kaçanik	101
62	Hajrije Zhubi	Rushta	Mostar	Baballog	Deçan	101
63	Esref Esati	Kukulan	Dragash	Kukulan	Dragash	101
64	Zef Tetaj	Ramoc	Gjakovë	Ramoc	Gjakovë	100
65	Xhemile Luzha	Begracë	Kaçanik	Kaçanik	Kaçanik	100
66	Rashid Crnovrshani	Zminac	Bijelo Polje	Zminac	Bijelo Polje	100
67	Dilaver Jusufi	Skorobishtë	Prizren	Lubizhdë	Prizren	100
68	Zelfije Bajraktari	Qubrel	Skenderaj	Klinë e Epërme	Skenderaj	100
69	Avdullah Xhafa	Bare	Mitrovicë	Bare	Mitrovicë	100
70	Agush Curri	Dërmjak	Kaçanik	Dërmjak	Kaçanik	100
71	Sherife Ninaj	Lubizhdë e Hasit	Prizren	Milaj	Prizren	100
72	Xhevahire Rashica	Lismir	Fushë Kosovë	Studime e Poshtme	Vushtri	100
73	Muharrem Bollopoja	Lebane	Prishtinë	Lebane	Prishtinë	100

Nga tabela shihet se personi më i moshuar në Kosovë është i gjinisë femërore, **Feride Bucolli** nga Glllogoci, gjersa, prej meshkujve, **Sylë Tahiri** nga fshati Shahiq komuna e Kamenicës.

Të moshuarit sipas vitit të lindjes

Nga tabela në vijim shihet se në Kosovë 2 të moshuar të gjinisë femërore janë të lindur në shekullin XIX-të. Kjo tregon se këto të moshuara kanë prekur 3 shekuj XIX , XX dhe shekullin XXI.

Viti i lindjes	Nr. i personave	%
1899	2	2.7
1900	13	17.8
1901	3	4.1
1902	4	5.5
1903	5	6.8
1904	8	11.0
1905	18	24.7
1906	10	13.7
1907	10	13.7
Gjithsej	73	100



Të moshuarit sipas lartësisë mbidetare të vendbanimit

Spektori i GIS-it në ESK ka nxjerr lartësinë mbidetare të vendbanimeve ku jetojnë tani (sipas vendqëndrimit të përhershëm) të moshuarit. Një pjesë e madhe e të moshuarve kanë jetuar në vendbanime tjera e që tani kishin ndërruar vendbanimin për shkak të kushteve në ato vise.

Në lartësinë mbidetare 300 – 600m jetojnë 63 %, në lartësinë mbidetare prej 601-900 jetojnë 23.3% në atë 901-1200 jetojnë 9,6% dhe 1201 e më tepër jetojnë 4.1% e të moshuarve.

Lartësia mbidetare sipas vendqëndrimit të përhershëm


Lartësia mbidetare	Nr.i personave	%
300 - 600	46	63.0
601 - 900	17	23.3
901 - 1200	7	9.6
1201+	3	4.1
Gjithsej	73	100.0

Të moshuarit sipas gjinisë

Statistikat demografiko-shëndetësore tregojnë se femrat jetojnë më gjatë se meshkujt për 4-5 vite, kjo shihet edhe nga ky hulumtim.

Nga të dhënat del se numrin më të madh të të moshuarve në Kosovë e përbejnë femrat me 57 apo 78.1%, dhe meshkujt 16 apo 21.9% persona.

Nga gjithsej 15 persona që janë mbi moshën 107 vjeç, vetëm një prej tyre është mashkull.



Të moshuarit sipas statusit martesorë¹

Pjesa dërmuese e të moshuarve 72 persona apo 98.6% kanë qenë të martuar një apo më shumë herë gjatë jetës së tyre. Është karakteristike të ceket se nga ky kontingjent i të moshuarve vetëm një person i gjinisë mashkullore nuk është martuar asnjëherë.

Një herë të martuar gjatë jetës së tyre janë 54 persona apo 75%. Prej tyre meshkujt 66.7 dhe femrat 77.2 %

Dy herë të martuar janë 14 persona apo 19.4%. Prej tyre meshkujt më 13.3 dhe femrat 21.1%

Tri e më shumë herë të martuar janë 4 personave apo 5.6%. Prej tyre meshkujt më 20% dhe femrat 1.7%.

Gjatë të gjitha intervistave që janë zhvilluar, nuk është takuar asnjë çift mbi moshën 100 vjeçare.

Të martuar gjatë jetës	Gjithsej	Të shprehur në %	Meshkuj		Femra	
Një herë	54	73.9	10	62.5	44	77.1
Dy herë	14	19.2	2	12.5	12	21.1
Tri e më shumë herë	4	5.5	3	18.8	1	1.8
Asnjëherë	1	1.4	1	6.2	0	0.0
Gjithsej	73	100.0	16	100.0	57	100.0

Të moshuarit dhe pasardhësit

Më lartë është cekur se nga 73 persona të kësaj moshe, 72 prej tyre ishin të martuar gjatë jetës. Nga të dhënat që janë nxjerrur shohim se jo të gjithë kanë lënë pasardhës. Prej 73 personave mbi moshën 100 vjeçare, 11 persona apo 15.1% nuk kishin pasardhës. Mesatarja e pasardhëseve për personat e martuar është rreth 46.1 persona për secilin.

Të moshuarit sipas profesionit

Duke u bazuar në periudhën kohore në të cilën kanë jetuar, pjesa dërmuese e të moshuarve me profesion ishin amvise apo bujk. Prej tyre 80,0% nga kontingjenti i meshkujve me profesion ishin bujk derisa, pjesa tjetër 20% minatorë. Tek femrat 96.4% amvise dhe 3.6% merreshin më artizanat. Është karakteristike të ceket se edhe pse tre prej tyre me profesion ishin minator (që cilësohet si punë e rëndë) kanë kaluar mbi 100 vite jetë.

Profesioni	Meshkuj	Femra
Bujk	80.0	0.0
Amvise	0.0	96.4
Artizanat	0.0	3.6
Minatorë	20.0	0.0

¹ Nënkupton statusin martesor të cilin e kanë pasur më parë

Të moshuarit dhe konsumimi i duhanit

Në momentin kur janë zhvilluar intervistat shohim se 84.9 % nuk e kanë konsumuar asnjëherë duhanin, gjersa 15.1% raportojnë se e konsumojnë.

Nga gjithsej 11 konsumues të duhanit, 3 apo 27.3% janë meshkuj dhe 8 apo 72.7% janë femra.

Në raport meshkuj me meshkuj dhe femra me femra, shohim se meshkujt konsumojnë duhan 18.8 % ndërsa femrat 14%.

A keni konsumuar duhan	Gjithsej		Meshkuj		Femra	
	nr.	%	nr.	%	nr.	%
PO	11	15.1	3	18.8	8	14.0
JO	62	84.9	13	81.2	49	86.0
Gjithsej	73	100.0	16	100.0	57	100.0

Të moshuarit dhe konsumimi i ushqimit

Në pyetjen se çfarë lloji të bukës kanë përdorur më shumë gjatë jetës, pjesa më e madhe e të intervistuarave janë deklaruar se gjatë jetës se tyre më shumë kanë konsumuar bukën dhe produktet e misrit 47.9%, të përziera 32.9%, pastaj të grurit 13.7% etj. Shih tabelën e mëposhtme.

Kodi	Lloji i bukës së konsumuar	Numri i të moshuarve	%
1	Bukë Misëri	35	48.0
2	Bukë Gruri	10	13.7
3	Bukë Thekre	2	2.7
4	Bukë Elbi	2	2.7
5	Të përziera	24	32.9
	Gjithsej	73	100.0

Të moshuarit dhe përdorimi i yndyrave

Nga të dhënat në tabelën e më poshtme shihet se 66 persona apo (90.5%) janë deklaruar se kanë përdorur yndyrat nga gjedhet dhe pjesa tjetër janë deklaruar se kanë përdorur vajin apo diçka tjetër.

Kodi	Llojet e yndyrave të konsumuara	Numri i të moshuarve	%
1	Yndyre gjedhi	66	90.5
2	Vaj	5	6.8
3	Tjetër	2	2.7
	Gjithsej	73	100.0

Të moshuarit dhe përdorimi i alkoolit

Nga tabela në vijim shihet se 69 të moshuar ose 94.5% janë deklaruar se asnjëherë nuk kanë konsumuar alkoolin, ndërsa vetëm 4 persona ose 5.5% janë deklaruar se e kanë konsumuar ndonjëherë.

Konsumimi i alkoolit	Nr i të moshuarve	%
Asnjëherë	69	94.5
Ndonjëherë	4	5.5
Gjithsej	73	100.0

Të moshuarit dhe gjendja shëndetësore

Nga të gjithë personat që janë vizituar shumica prej tyre kanë pasur shëndet të kënaqshëm. Prej tyre dy persona kanë pasur gjendje të vështirë shëndetësore.

Gjithsej		E mirë		E kënaqshme		Jo e mirë		Tjetër	
Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
35	48.0	10	43.5	19	57.6	5	33.3	1	50.0
10	13.7	3	13.0	2	6.1	5	33.3	0	0.0
2	2.7	0	0.0	2	6.1	0	0.0	0	0.0
2	2.7	0	0.0	2	6.1	0	0.0	0	0.0
24	32.9	10	43.5	8	24.2	5	33.3	1	50.0
73	100.0	23	100.0	33	100.0	15	100.0	2	100.0

Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës së Kosovës, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Enti i Statistikës së Kosovës vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi më 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

Struktura organizative e ESK-së, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës.

Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.

Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

Misioni i Entit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa:** Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë
- **Telefonat:**
Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111
Drejtori: +381 (0) 38 235 545 ose +381 (0) 38 504 604 lok. 6572
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** population@ks-qov.net
- **Ueb-faqe:** www.ks-qov.net/esk